



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER LORIANA A. ROBO
ADRESA NR.5, ISMAIL QEMALI,
NR.27, NR.1, NR.1
TEL: 694070762



KRIJIMI I SHOQATAVE OSE AKTI I THEMELIMIT (KRIJIMI I QËNDRES)

Nr. repertori: 4120

Nr. koleksioni: 833

Tirane më 19/11/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 9 fletë



A2020050250081160512



AKT THEMELIMI I SHOQATES
“AGJENCIA E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV FABER COLLECTIVE PHONOGRAM”
Date 19.11.2020

Sot, më datë 19.11.2020, para meje Noter LORIANA A. ROBO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.27, NR.1, NR.1, themelohet Shoqata “Agjencia e Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram” sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1

Forma ligjore dhe themeluesit

1.1. Shoqata “Agjencia e Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram” (ne vijim “Shoqata” ose “Agjencia”) është person juridik, e themeluar ne formen e shoqates ne perputhje me dispozitat e Kodit Civil, Ligjit nr. 8788 date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimpruese” i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8789, date 07.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jofitimpruese”, e cila perfaqeson bashkimin vullnetar te personave juridike, personave fizike dhe vecanerisht mbajteseve te te drejtave te autorit dhe te drejtave te lidhura me te. Ne perputhje me Ligjin nr. 35/2016 “Per te drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me to” dhe akteve nen-ligjore ne zbatim te tij si dhe ne perputhje me licensen perkatese, Shoqata vepron si Agjenci e Administrimit Kolektiv me qellim mbledhjen e te ardhurave per perdorimin e veprave dhe shperndarjen e tyre tek titullaret e se drejtes se autorit dhe te drejtave te lidhura me to.

1.2. Themeluesit e Shoqates jane: (i) Faber Media Sh.p.k. nje shoqeri e regjistruar dhe qe vepron sipas legjislacionit te Republikes se Kosoves, me nr. unik identifikues 811395624, seli Rr. Agim Ramadani nr. 292, 3 Prishtine dhe (ii) Faber Digital Sh.p.k. nje shoqeri e regjistruar dhe qe vepron sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, me nr. NUIS L62207020Hseli Rruga D. Hima, Hyrja 1, Ap. 50, Zona Kadastrale Nr.8160, Nr. Pasurise 6/410+1-50, Vol 42,Fq.181.

Neni 2

Emri, selia, vula dhe logo

2.1. Emri i plote i Shoqates eshte Agjencia e Administrimit Kolektiv Faber Collective, ose shkurtimisht “Faber Collective Phonogram”.

2.2. Selia e Agjencise ndodhet ne adresen: Rruga D. Hima, Hyrja 1, Ap. 50, Zona Kadastrale Nr.8160, Nr. Pasurise 6/410+1-50, Vol 42, Fq.181, Tiranë, Shqipëri, dhe do te ushtroje veprimtarine e saj brenda territorit te Republikes se Shqiperise duke krijuar edhe dege ne qytete te tjera sipas nevojës.

2.3. Agjencia do te kete vulen dhe logon e saj dhe te gjitha dokumentet e leshuara nga Agjencia do te mbajne vulen dhe logon e saj. Gjithashtu, Agjencia do te jete e pajisur me website zyrtar.

Neni 3


Lloji i veprimtarise dhe objekti

3.1. Agjencia eshte nje organizate jofitimpruese e organizuar ne perputhje me dispozitat e Ligjit nr. 8788 date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimpruese” i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8789, date 07.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jofitimpruese”, i ndryshuar.

3.2. Objekti i vetem i veprimtarise se Agjencise do te jete administrimi kolektiv i te drejtave te autorit dhe te drejtave te lidhura, ne perputhje me Ligjin nr. 35/2016 “Per te drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me to” dhe akteve nen-ligjore ne zbatim te tij si dhe ne perputhje me licensen perkatese. Agjencia



ka si-qellim mbledhjen e te ardhurave per perdorimin e veprave dhe shperndarjen e tyre tek titullaret e se drejtes se autorit dhe te drejtave te lidhura me to dhe konkretisht administrimin kolektiv te te drejtave te prodhuesve te fonogramit, interesat e te cileve Agjencia perfaqeson dhe me te cilet do te lidhe kontratat perkatese.



Neni 4

Kohezgjatja

4.1. Agjencia do te veproje per nje periudhe te pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit te tij prane Regjistrimit te Organizatave Jofitimprurese te mbajtur prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ne rast se nuk priset me pare ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe legjislacionit te zbatueshem.

Neni 5

Financimi i Agjencise

5.1. Fondet e Agjencise do te perbehen nga:

- regjistrimet e anetareve dhe kuotat perkatese, sipas percaktimeve te Asamblese se Pergjithshme;
- fondet nga autoritete publike, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi;
- burime te tjeter te ligjshme.

Neni 6

Viti Financiar

6.1. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon me regjistrimin e Agjencise ne Regjistrin e Organizatave Jofitimprurese prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane dhe perfundon ne fund te vitit kalendarik perkates.

Neni 7

Organet Drejtuese te Agjencise

7.1. Organet e Agjencise jane: (i) Asambleja e Pergjithshme dhe (ii) Keshilli i Administrimit.

7.2. Presidenti i Keshillit do te ushtroje kompetenca ekzekutive per llogari te Keshillit te Administrimit, dhe do te jete i autorizuar te perfaqesoje Agjencine ne marredhenie me palet e treta, perfshire autoritetet publike, organizatat homologe, institucione financiare dhe te tjera.

Neni 8

Anetaresia

8.1 Anetaresimi ne Agjenci eshte vullnetar dhe i hapur per te gjithë titullaret e te drejtave te autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me to dhe veçanerisht, prodhuesit prodhuesit e fonogramit.

8.2. Titullaret e te drejtave te autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura duhet te paraqesin nje kerkese anetaresimi te plotesuar prane Agjencise, ne te cilen nder te tjera pranohet dhe njihet ky Statut, Rregulloret e Brendshme te Agjencise si dhe vendimet te tjera te marra nga Agjencia, sipas modaliteve te percaktuara nga njoftimet perkatese te Agjencise ne kanale te ndryshme komunikimi.

Neni 9

Prishja dhe Likuidimi i Agjencise

9.1. Agjencia mund te priset me vendim te Asamblese se Pergjithshme, ne perputhje me ligjin e zbatueshem.

9.2. Ne rast prishje, Asambleja e Pergjithshme ose gjykata sipas rastit, emeron likuiduesin/t qe te kujdeset/-n per asetet e Agjencise.

Neni 10

Ligji i Zbatueshem dhe Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

10.1. Ky Statut hartohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

10.2. Çdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ketij Statuti do te



zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 11
Te ndryshme

11.1. Ky Akt Themelimi hartohet ne 4 kopje, ne gjuhen shqipe, secila me vlere te njejte ligjore.

11.2. Themeluesit autorizojne Boga & Associates, ne personat e Znj. Gladiola Ago, Z. Trojan Pavlovski dhe ose Z. Flavio Isaraj, qe se bashku ose vecmas, te ndermarrin e te kryejne te gjitha procedurat per regjistrimin e Agjencise prane Regjistrat te Organizatave Jo Fitimprurese te mbajtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Une Noteri ia lexoj tekstin e ketij akti me ze te larte themeluesve, per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentat qe me paraqiten (ketu bashkengjitur).

Nenshkruesit deklarojne se permbajtja perputhet plotesisht me vullnetin e tyre dhe e nenshkruajne kete akt me vullnetin e tyre te plote e te lire, ne pranine time dhe une Noteri e vertetoj kete akt sipas ligjit.

THEMELUESIT

FABER MEDIA SHPK



Perfaqesuar rregullisht nga Administrator Znj. Anxhela Faber

FABER DIGITAL SHPK



Perfaqesuar rregullisht nga Administrator Znj. Anxhela Faber

NOTER
LORIANA A. ROBO





TAKSA E PULLËS
E PAGUAR
Noter Lorian A. Robo



STATUT I SHOQATES

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV FABER COLLECTIVE PHONOGRAM

Date 19.11.2020

Neni 1

Forma ligjore dhe themeluesit

1.1. Shoqata **“Agjencia e Administrimit Kolektiv Faber Collective Phonogram”** (ne vijim **“Shoqata”** ose **“Agjencia”**) eshte person juridik, e themeluar ne formen e shoqates ne perputhje me dispozitat e Kodit Civil, Ligjit nr. 8788 date 07.05.2001 *“Per organizatat jofitimpruese”* i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8789, date 07.05.2001 *“Per regjistrimin e organizatave jofitimpruese”*, e cila perfaqeson bashkimin vullnetar te personave juridike, personave fizike dhe veçanerisht mbajteseve te te drejtave te autorit dhe te drejtave te lidhura me te. Ne perputhje me Ligjin nr. 35/2016 *“Per te drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me to”* dhe akteve nen-ligjore ne zbatim te tij si dhe ne perputhje me licensen perkatese, Shoqata vepron si Agjenci e Administrimit Kolektiv me qellim mbledhjen e te ardhurave per perdorimin e veprave dhe shperndarjen e tyre tek titullaret e se drejtes se autorit dhe te drejtave te lidhura me to.

1.2. Themeluesit e Shoqates jane: (i) Faber Media Sh.p.k. nje shoqeri e regjistruar dhe qe vepron sipas legjislacionit te Republikes se Kosoves, me nr. unik identifikues 811395624, seli Rr. Agim Ramadani nr. 292, 3 Prishtine dhe (ii) Faber Digital Sh.p.k. nje shoqeri e regjistruar dhe qe vepron sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, me nr. NUIS L62207020Hseli Rruga D. Hima, Hyrja 1, Ap. 50, Zona Kadastrale Nr.8160, Nr. Pasurise 6/410+1-50, Vol 42,Fq.181.

Neni 2

Emri, selia, vula dhe logo

2.1. Emri i plote i Shoqates eshte Agjencia e Administrimit Kolektiv Faber Collective, ose shkurtimisht **“Faber Collective Phonogram”**.

2.2. Selia e Agjencise ndodhet ne adresen: Rruga D. Hima, Hyrja 1, Ap. 50, Zona Kadastrale Nr.8160, Nr. Pasurise 6/410+1-50, Vol 42,Fq.181, Tiranë, Shqipëri, dhe do te ushtroje veprimtarine e saj brenda territorit te Republikes se Shqiperise duke krijuar edhe dege ne qytete te tjera sipas nevojës.

2.3. Agjencia do te kete vulen dhe logon e saj dhe te gjitha dokumentet e leshuara nga Agjencia do te mbajne vulen dhe logon e saj. Gjithashtu, Agjencia do te jete e pajisur me website zyrtar.

Neni 3

Lloji i veprimtarise dhe objekti

3.1. Agjencia eshte nje organizate jofitimpruese e organizuar ne perputhje me dispozitat e Ligjit nr. 8788 date 07.05.2001 *“Per organizatat jofitimpruese”* i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8789, date 07.05.2001 *“Per regjistrimin e organizatave jofitimpruese”*, i ndryshuar.

3.2. Objekti i vetem i veprimtarise se Agjencise do te jete administrimi kolektiv i te drejtave te autorit dhe te drejtave te lidhura, ne perputhje me Ligjin nr. 35/2016 *“Per te drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me to”* dhe akteve nen-ligjore ne zbatim te tij si dhe ne perputhje me licensen perkatese. Agjencia ka si qellim mbledhjen e te ardhurave per perdorimin e veprave dhe shperndarjen e tyre tek titullaret e se drejtes se autorit dhe te drejtave te lidhura me to dhe konkretisht administrimin kolektiv te te drejtave te prodhuesve te fonogramit, interesat e te cileve Agjencia perfaqeson dhe me te cilet do te lidhe kontratat perkatese.

3.3. Objekti i mesiperm do te perfshije:

- dhenien per perdoruesit, ne vijim te kerkesave te tyre, kontrata ne formen joekskluzive per perdorimin e veprave ose objekteve te te drejtave te lidhura, ne kembim te nje shperblimi;
- te mbledhe shperblimin per perdorimin e veprave ose objekteve te te drejtave te lidhura;
- te shperndaje, ne baze te rregullave te shperndarjes, shperblimin e mbledhur nga perdoruesit ne menyre te



drejte dhe te perpjesetuar me vleren dhe perdorimin aktual te veprave e te objekteve te te drejtave te lidhura.

- te perfaqesoj mbajtesit e te drejtave, te drejtat e te cileve ata administrojne, ne procedurat gjyqesore ose administrative dhe te kryejne çdo veprim tjeter ligjor te nevojshem per mbrojtjen dhe zbatimin e te drejtave te administruara nga ato;
- te kryejne çdo veprim tjeter, ne perputhje me tagrat e tyre ligjore dhe te organeve te veta vendimmarrese, per kompetencat e marra nga mbajtesit e te drejtave;
- te hartoje metodologji te negociueshme per percaktimin e nivelit te tarifave qe subjektet perdoruese duhet te paguajne, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji;
- te realizoje ne emer te autorit ose te mbajtesit te se drejtes se autorit dhe te te drejtave te tjera te lidhura me te ose ne baze te kontrates se reciprocitetit me agjenci te huaja te ngjashme marreveshjet e pergjithshme me organizatorete e shfaqjeve, me ofruesit e sherbimit mediatik audioviziv, me operatorete e rrjetit numerik, qe kane si objekt autorizimin e shfaqjes dhe shperndarjes per veprat qe administrojne;
- te perfaqesoj interesat e anetareve per shfrytezimin e te drejtave, jashte territorit te Republikes se Shqiperise, duke nenshkruar kontratat e reciprocitetit me agjenci te huaja te ngjashme;
- te informoje, sipas kerkeses, mbajtesit e te drejtave te autorit dhe te te drejtave te tjera te lidhura me to per menyren e shfrytezimit te te drejtave te tyre, per raportin vjetor financiar dhe ate te kontrollit te te ardhurave financiare, brenda kohes se parashikuar ne statut;
- te siguroje transparencen e veprimtarise se agjencise se administrimit kolektiv, ne lidhje me autoritetet publike te kontrollit, sipas ligjit;
- per te ardhurat e mbledhura nga perdoruesit dhe qe u paguhet ne forme
- paguan tatimin ne burim, per shperblimin e paguar tek mbajtesit e te te drejtave.

3.4. Agjencia perfaqeson ligjerisht duke perfaqesuar titullaret e te drejtave te autorit ne Republiken e Shqiperise sipas kontratave perkatese apo te titullareve te huaj te te drejtave te autorit, ne perputhje me kontratat reciproke te lidhura me agjenci te huaja.

Neni 4 Kohezgjatja

4.1. Agjencia do te veproje per nje periudhe te pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit te tij prane Regjistrimit te Organizatave Jofitimpruresse te mbajtur prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ne rast se nuk prishet me pare ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe legjislacionit te zbatueshem.

Neni 5 Financimi i Agjencise

5.1. Fondet e Agjencise do te perbehen nga:

- regjistrimet e anetareve dhe kuotat perkatese, sipas percaktimeve te Asamblese se Pergjithshme;
- fondet nga autoritete publike, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi;
- burime te tjeter te ligjshme.

5.2. Shpenzimet e Agjencise ne kuader te ofrimit te sherbimeve te saj, shperblimet e tjera me qellim stimulimin e mbajtesve te te drejtave, veprat e te cileve perfaqesojne nje vlere te vecante per kulturen dhe krijimtarine kombetare, percaktimi i shumave qe duhet te paguhet pas zbritjes se kosos per administrimin e se drejtes, ndarja e fondeve te parashikuara nga ligji, nga ky Statut i Agjencise ose nga kontratat nderkombetare per perfaqesimin e perbashket te AAK-ve; si dhe kushtet per llogaritjen dhe pagesen e shperblimeve te shperndara do te percaktohen ne Rregulloren e Brendshme te Agjencise.

5.3. Agjencia do te kete kompetence dhe do te ushtroje, ne perputhje me kufizimet e percaktuara ne kete Statut ose ne legjislacionin e zbatueshem, sa me poshte:

- te bleje, te marre ose te perfitoje ne çdo forme, te zoteroje, te shese, te jape me qira, te kembeje, te transferoje ose te disponoje ne çdo forme, te lere peng, te perdore dhe te hyje ne marreveshje me objekt pasuri reale dhe personale, kapitale dhe instrumente monetare te vetat ose te te treteve;
- te marre persiper detyrime, te lidhe kontrata, perfshire kontrata garancie ose dorezanie, te marre persiper pergjegjesi, te marre ose jape hua, ose t'i perdore instrumentet e veta monetare ne çdo menyre, te garantoje detyrimet, kontratat ose pergjegjesite e veta me ane te pengut ose hipotekes, ose te vere barre te çdo forme mbi pasurit e ardhurat e veta;



- te marre pjese ne ortakeri me te trete, ne ndermarrje te perbashketa ose ne çdo forme organizimi, veprimtarie ose mareveshjeje ne te cilat kontrolli mund te ushtrohet ne menyre te perbashket me te trete ose jo.

5.4. Llogaritje e Agjencise do te mbahen ne perputhje me ligjin shqiptar dhe te ardhurat dhe shpenzimet e Agjencise do te menaxhohen ne perputhje parimet e transparences, sipas vendimit perkates te Asamblese se Pergjithshme.

5.5 Shperndarja per titullaret e te drejtave do te behet sipas informacionit te disponueshem ne lidhje me perdorimin e fonogrameve apo videogrameve, duke siguruar nje shperndarje sa me efikase dhe transparente sipas percaktimeve ne Rregulloren e Brendshme te Agjencise.

Neni 6

Viti Financiar

6.1. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon me regjistrimin e Agjencise ne Regjistrin e Organizatave Jofitimprurese prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane dhe perfundon ne fund te vitit kalendarik perkates.

Neni 7

Organet Drejtuese te Agjencise

7.1. Organet e Agjencise jane: (i) Asambleja e Pergjithshme dhe (ii) Keshilli i Administrimit.

7.2. Keshilli i Administrimit ka te drejte te krijojte komisione te posaçme.

Neni 8

Asambleja e Pergjithshme, Kompetencat dhe Perberja

8.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte drejtues Agjencise, e cila mbledhet te pakten nje here ne vit.

8.2 Asambleja e Pergjithshme perbehet nga te gjithe anetaret e saj te cilet kane te drejten e 1 (nje) vote. Anetaret perfaqesohen individualisht apo nepermjet nje perfaqesuesi, mbi bazen e nje autorizimi apo prokure te rregullt.

8.3 Mbledhjet e Asamblese thirren nga Presidenti i Keshillit te Administrimit, ose nepermjet personave te autorizuar prej tij. Njoftimi me shkrim apo elektronik (perfshire publikimin) duhet t'i dergohet te gjithe anetareve te pakten 15 dite kalendarike perpara dates se mbledhjes pervec kur ka ndonje urgjence. Ne kete rast, njoftimi mund te behet nepermjet telefonit ose menyrave te tjera te komunikimit, duke treguar nje kohe te pershtatshme per mbledhjen ne varesi te emergjences. Ne çdo rast, njoftimi per mbledhjen duhet te permbaje daten, oren, vendin dhe rendin e dites se mbledhjes.

8.4 Anetaret e Asamblese se Pergjithshme mund te marrin pjese dhe te votojne ne mbledhje nepermjet formave te ndryshme te komunikimit, perfshire mjetet elektronike me kusht qe identifikohen rregullisht.

8.5 Kuorumi i nevojshem perbehet nga me shume se $\frac{1}{2}$ e anetareve te Asamblese. Vendimet e Asamblese, pervec kur percaktohet ndryshe merren me shumice te thjeshte te anetareve te pranishem ne mbledhje. Secili anetar ka te drejten e votes. Abstenimet nuk do te pranohen. Ne rast barazie votash, do te ftohet te votoje Presidenti i Keshillit te Administrimit, vota e te cilit do te jete percaktuese. Vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te nenshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, te cilet caktohen here pas here, nga Asambleja e Pergjithshme.

8.6 Asambleja e Pergjithshme, si organi me i larte vendimmarres, ka te gjitha kompetencat, funksionet dhe detyrat e percaktuara nga Ligji nr. 8788, date 07.05.2001 "Per organizatat jo fitimprurese", i ndryshuar si dhe ne kete Statut. Ne veçanti, Asambleja e Pergjithshme ka kompetencat e meposhtme:

1. vendos mbi ndryshimet e Statutit, te cilat miratohen nga ministria pergjegjese per sportin;
2. zgjedh dhe emerone anetaret e Keshillit te Administrimit;



3. përcakton dhe mbikeqyr strategjitë e përgjithshme të Agjencisë;
4. miraton pasqyrat financiare dhe buxhetin për aktivitetet;
5. keshillon dhe mbikeqyr përdorimin e fondeve;
6. vendos dhe e riatë aktivitetet ekonomike konsiderohen të nevojshme për të përmbushur qëllimet e Agjencisë;
7. cakton komitete/komisione të veçanta për projekte të ndryshme dhe përcakton kompetencat e tyre dhe buxhetin e duhur për veprimtarinë;
8. përcakton të ardhurat neto nga fitimet në përputhje me veprimtaritë e miratuara dhe angazhimet e Agjencisë;
9. siguron që të kryhen të gjitha pagesat kundrejt kreditorëve dhe të mbledhen të gjitha borxhet, nëse ka të tilla, kundrejt Agjencisë.

Neni 9 Anetaresia

9.1 Anetaresimi në Agjenci është vullnetar dhe i hapur për të gjithë titullarët e të drejtave të autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to dhe veçanërisht, prodhuesit prodhuesit e fonogramit.

9.2. Titullarët e të drejtave të autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura duhet të paraqesin një kërkesë anetaresimi të plotësuar pranë Agjencisë, në të cilën ndër të tjera pranohet dhe njihet ky Statut, Rregulloret e Brendshme të Agjencisë si dhe vendimet të tjera të marra nga Agjencia, sipas modaliteteve të përcaktuara nga njoftimet përkatëse të Agjencisë në kanale të ndryshme komunikimi.

9.3. Çdo anetar mund të heqë dorë nga anetaresia duke njoftuar me shkrim Këshillin e Administrimit gjatë muajit para datës 31 dhjetor të çdo viti.

9.4. Anetarët përjashtohen nga Agjencia,

- Kryejnë veprime që demtojnë Agjencinë, qëllimet e saj dhe/ose të anetaresëve të tjerë;
- Nuk paguajnë kuotat e anetaresisë;
- Shkelin dispozitat e statutit dhe shoqatës.

Neni 10 Këshilli i Administrimit

10.1 Këshilli i Administrimit përbëhet nga 5 anetarë, si më poshtë:

1. President;
2. Dy Zëvendës President.
2. Sekretar i Përgjithshëm;
3. Financier.

10.2 Anetarët e Këshillit të Administrimit, zgjidhen nga Asambleja me votim. Mandati i tyre është 3 (tre) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.

10.3 Këshilli i Administrimit, mbledhet jo më pak se 3 herë në vit, dhe mbledhjet drejtohen nga Presidenti. Njoftimi me shkrim apo elektronik (përfshirë publikimin) duhet t'i dërgohet të gjithë anetaresëve të Këshillit të paktën 15 ditë kalendarike përpara datës së mbledhjes përveç kur ka ndonjë urgjencë. Në këtë rast, njoftimi mund të bëhet nëpërmjet telefonit ose menyrave të tjera të komunikimit, duke treguar një kohë të përshtatshme për mbledhjen në varësi të emergjencës. Në çdo rast, njoftimi për mbledhjen duhet të përmbajë datën, orën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes.

10.4 Anetarët e Këshillit mund të marrin pjesë dhe të votojnë në mbledhje nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit, përfshirë mjetet elektronike me kusht që identifikohen rregullisht.

10.5 Kuorumi i nevojshëm përbëhet nga më shumë se ½ e anetaresëve të Këshillit. Vendimet e Këshillit, përveç kur përcaktohet ndryshe merren me shumicë të thjeshtë të anetaresëve të pranishëm në mbledhje. Secili anetar ka të drejtën e votes. Abstenimet nuk do të pranohen. Në rast barazie votash, vota e Presidentit do të jetë përcaktuese. Vendimet e Këshillit duhet të nënshkruhen nga të gjithë anetarët e pranishëm.



10.6 Keshilli i Administrimit, administron veprimtarine e Agjencise, perfshire, por pa u kufizuar ne sa me poshte:

1. zbatimin e vendimeve te Asamblese se Pergjithshme
2. administrimit te perditshem te veprimtarise se Agjencise;
3. emerimin dhe ose largimin nga puna te punemarresve;
4. hartimin e regjulloreve ne zbatim te ketij Statuti (perfshire ato qe i perkasin anetaresimeve te reja);
5. merr ne shqyrtim kerkesat per anetaresim dhe/ose licensim;
6. i paraqet Asamblese se Pergjithshme pasqyrave financiare vjetore dhe siguron qe keto pasqyra financiare te miratohen brenda 6 (gjashte) mujorit te pare pas mbylljes se vitit financiar;
7. siguron mbarevajtjen e projekteve dhe programeve te miratuara nga Asambleja e Pergjithshme, dhe ben emerimin e personave pergjegjes per te realizuar keto aktivitete ose projekte;
8. miraton strukturen dhe organiken e Agjencise;
9. miraton te gjitha shpenzimet dhe veprimet me llogarite bankare te Agjencise;
10. harton projekte dhe programe qe mund te jene te nevojshme per realizimin e qellimit te Agjencise;
11. mban dhe ruan te gjithe dokumentacionin e Agjencise dhe vulen e tij, perfshire dokumentacionin financiar e te tjera qe lidhen me aktivitetin e Agjencise.

10.7 Presidenti i Keshillit do te ushtroje kompetenca ekzekutive per llogari te Keshillit te Administrimit, dhe do te jete i autorizuar te perfaqesoje Agjencine ne marrredhenie me palet e treta, perfshire autoritetet publike, organizatat homologe, institucione financiare dhe te tjera.

10.8 Anetare te pare te Keshillit te Administrimit, te cilet zgjidhen nga Asambleja e Pergjithshme/themeluesit jane:

1. President: Anxhela Faber
2. Zevendes President (1): Estela Ruka
3. Zevendes President (2): Vjollca Haxhiu
4. Sekretar i Pergjithshem: Xhensila Zhoga
5. Financier: Aldor Nini.

Neni 11

Transparenca dhe informimi

11.1. Agjencia ka detyrimin per te publikuar, ne format elektronik, ne faqen e tyre te internetit, informacionin e perditesuar si me poshte:

- statutin;
- listen e anetareve dhe te organeve te administrimit, perberjen e komisioneve te brendshme dhe listen e administratoreve lokale (nese ka);
- deklaraten vjetore ne lidhje me bilancin e shumave jo te shperndara, shumet e mbledhura nga kategorite e perdoruesve ose paguesve, shumet e mbajtura ne burim, koston e administrimit dhe shumet e shperndara nga kategorite e pronareve/ autoreve;
- raportin vjetor;
- informacion per asamblene e pergjithshme, per shembull: daten, vendin e thirrjen, agjenden, projektvendimet dhe vendimet e miratuara;
- te dhena te tjera te nevojshme per anetaret, per qellime informimi.

Neni 12

Prishja dhe Likuidimi i Agjencise

12.1. Agjencia mund te priset me vendim te Asamblese se Pergjithshme, ne perputhje me ligjin e zbatueshem.

12.2. Ne rast prishje, Asambleja e Pergjithshme ose gjykata sipas rastit, emeron likuiduesin/t qe te kujdeset/-n per asetet e Agjencise.

Neni 13

Ligji i Zbatueshem dhe Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

13.1. Ky Statut hartohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.



13.2. Çdo mosmarreveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij Statuti do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 14
Te ndryshme

Ky Statut hartohet në 4 kopje, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjte ligjore.

Une Noteri ja lexoj tekstin e këtij akti me zë të lartë themeluesve, për identitetin e të cileve u sigurova nga dokumentat që më paraqiten (ketu bashkëngjitur).

Nenshkruessit deklarojnë se përmbajtja përputhet plotësisht me vullnetin e tyre dhe e nënshkruajnë këtë akt me vullnetin e tyre të plotë e të lirë, në praninë time dhe une Noteri e vertetoj këtë akt sipas ligjit.

THEMELUESIT

FABER MEDIA SHPK

Perfaqësuar rregullisht nga Administrator Znj. Anxhela Faber

Anxhela Faber

FABER DIGITAL SHPK

Perfaqësuar rregullisht nga Administrator Znj. Anxhela Faber

Anxhela Faber

NOTER
LORIANA A. ROBO

